



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:052030
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05743987

A.nr.620/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, P.E. nga ..., në adresën Rr. kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -Divizioni për Ndhim Socialë, Prishtinë, me bazën juridike: anulim i vendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të palës paditëse dhe mungesë të palës së paditur me datë 27.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, ... nga ..., kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -Divizioni për Ndhim Socialë me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të datës 29.12.2020, me numër 2058833 dhe paditësit të miratoj kërkesën për njohjen e të drejtës ndihmës sociale sipas masës 15 të Pakos Emergjente130 për periudhën prill 2020.

A r s y e t i m i

Seanca mbi shqyrtimin kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të palës paditëse dhe mungesë të palës së paditur, e ftuar në mënyrë të rregullt (Provë: fletë-kthesa e datës 27.05.2024).

Paditësi me padinë e datës 1903.2023, ka kërkuar nga gjykata të miratohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia si dhe të anulohet vendimit të datës 29.12.2020, me numër 2058833 dhe paditësit të miratoj kërkesën për njohjen e të drejtës ndihmës sociale sipas masës 15 të Pakos Emergjente130 për periudhën prill- 2020. Ndërsa, paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërekspadia si e bazuar dhe të anulohet vendimet kontesutes i të paditurës i datës 29.12.2021 si i pabazuar në ligj, ashtu që ti me njihet e drejta e pakos emergjente për periudhat e cekura si në padi.

E paditura, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -Divizioni për Ndhim Socialë, përmes Avokaturës Shtetërore në përgjigjen e dhënë në padi të datës 17.10.2022 ka theksuar se, e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka theksuar se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe se pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një prove të vetme, andaj i propozon gjykatës që të merr aktgjykim dhe ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm.

Gjykata për të vërtetuar besueshmërinë e kërkesëpadiës dhe gjendjen e plotë të fakteve, për të vendosur në këtë çështje juridike, në seancën e datës 27.05.2024, ka bërë administrimin e provave si: Formulari i shqyrtimit të ankesës i dt. 11.01.2021; vendimi i dt.29.10.2020; Deklarata e bashkësisë familjare e dt.17.03.2021; Deklarata nën betim me nr.2244/2021 të noteri Ali Riza; Njoftimi i dt.05.10.2022; Vendimi i dt.03.04.2020; Vendimi i dt. 16.04.2020; me nr.355/2020; Deklarata e dt.21.08.2020 dhe i dt.19.08.2020; Kërkesa për asistencë e dt.24.04.2020; vendimi i dt.29.10.2020; Formulari për shqyrtimin e ankesës e dt.11.01.2021; Vendimi i dt.11.01.2021; Dëftesa për pranimin e ankesës e dt.21.08.2020; Pasqyre e pagesave e dt.13.06.2020;Raporti i Verifikimit 7817 periudha 04-2020;Raporti i verifikimit 65863 periudha 05-2020; Raporti i verifikimit me nr.69853 periudha 05-2020; Periudha e verifikimit 0506 me nr.131909; Kërkesa e dt.24.08.2020

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Me vendimin e datës 29.12.2020, me numër 205833, refuzohet ankesa e këtij paditësit për muajt 04-2020, si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës ka iniciuar konflikt administrativ sipas padiës, duke e kontestuar ligjshmërinë e tyre.

Gjykata kishte parasysh vendimin nr.35/2020 datë 16.04.2020 pika dy ku përcaktohet e drejta e përfitimit në pagesë të asistencës mujore në vlerë prej njëqind e tridhjetë euro për periudhën prill-qershor 2020, familjet të cilat nuk kanë asnjë të punësuar (sektori publik dhe privat), nuk pranojnë asnjë pagesë mujore nga buxheti i Republikës së Kosovës (pension apo asistencë tjetër sociale), janë të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent dhe që janë banorë rezident në Republikën e Kosovës., si dhe pika tre e vendimit përcakton obligimin të jetë i regjistruar i papunë në Zyrën e Punësimit.

Ndërkaq në piken 5 është përcaktuar: Divizioni i Ndhimave sociale përmes sistemit elektronik të bazës së të dhënave bënë përpunimin dhe shkëmbimin e të dhënave të muajve paraprak për të verifikuar të hyrat

e aplikuesit dhe anëtareve të familjes nga skemat e pagesave sociale, pensionale dhe të hyrave tjera mujore të cilat mund të identifikohen nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Me tej, me Masën 15, Plani Operacional për Pakon Fiskale emergjente përcaktohet pagesa e asistencës mujore në vlerë prej njëqind e tridhjetë euro për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent, që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Republikës së Kosovës, për muajin prill, maj, qershor në vlerë deri në tre milion euro.

Gjykata ju referua edhe provave të tjera nga shkresat e lëndës si: raporti verifikimit nr.7817 për periudhën 04-2020, raporti verifikimit nr.69863 për periudhën 05.2020, raporti verifikimit me nr.131909 për periudhën 06-2020 ku në këto raporte është dhënë komenti: “Pas krahasimit të të dhënave tuaja me ARC ka rezultuar se numri i anëtarëve të familjes tuaj të paraqitur në Formularin e aplikimit D1 për Masën Nr.15, nuk përputhet me të dhënat nga Agjencia e Regjistrimit Civil dhe nëse dëshironi të ushtroni ankesë dhe nëse struktura e juaj ka ndryshuar prej kohës që ju keni deklaruar bashkësinë familjare ne ARC, atëherë ju lutemi të vizitoni zyrën e regjistrimit civil në komune tuaj dhe ta siguroi deklaratën e përditësuar të bashkësisë familjare dhe atë duke pasur parasysh vetëm peronat që ju keni paraqitur ne formularin e aplikimit D-1 m3 përjashtimisht nëse gjate kësaj kohe ka lindur. Me tej, gjykata vëren se, gjatë krahasimit të dhënave elektronike me Agjencinë e Regjistrimit Civil, Administratën Tatimore të Kosovës dhe skemat tjera pensione është vërtetuar se nena jeton në të njëjtën adresë banimi. Në Raportin e verifikimit të muajit prill, maj dhe qershor thuhet se, pas krahasimit të dhënave me ARC është konstatuar se ekzistojnë persona të lidhur me bashkësinë tuaj familjare që realizojnë të ardhura nga skema e pensioneve apo sociale m të njëjtën adresë banimi të cilët ju nuk i keni paraqitur ne momentin e aplikimit.

Gjykata kishte parasysh edhe përmbajtjen dhe formën e aktit administrative të atakuar me padi por se gjykata u lëshua në merita të shqyrtimit të kësaj çështjeje andaj paditësi nuk ka arritur të dëshmojë një gjendje faktike tjetër nga kjo e vërtetuar në shqyrtim gjyqësor, andaj edhe kthimi i lëndës në rishqyrtim pranë organit administrativ për arsye të përmbajtjes dhe formës së aktit vetëm do të zvarriste procedurën sepse nuk janë ofruar prova për konstatimin e një gjendjeje tjetër nga kjo e konstatuar.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit dhe gjeti se, të njëjtat në këtë çështje administrative, nuk kanë ndikim në vendosje tjetër, nga ajo që ka vendosur organi i paditur, sepse me provat e administruara, në kuptim të dispozitës së cekur ligjore, është vërtetuar se paditësi nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar.

Nga kjo, gjykata vlerëson se aktvendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen

faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka refuzuar ankesën e paditësit. Mbi këto arsye kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse sipas vlerësimit të gjykatës, nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lartë, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2, lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe 67 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.620/2021- Data:27.05.2024

Gjyqtare
Luljeta Maxhuni

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit , në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.